



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 të Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Th e r r a s

Mbledhjen e 214-të, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për datën **21 shkurt 2019 (E Enjte) nga ora 13:00**, në sallën e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Për mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E

TEMA		Koha orientuese për diskutim:
1	Shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit të takimit nr. 211 dhe 212 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës	10 min.
2	Autorizimi i Kryetarëve të Gjykatave të Republikës së Kosovës, për ushtrimin e përgjegjësive sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015, në zbatim të Vendimit të KGJK-së për delegimin e përgjegjësive në çështje të personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës, deri në marrjen e një Vendimi tjetër nga KGJK	5 min.
3	Kërkesë për caktimin e Nënkyetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë	5 min.
4	Kërkesë për caktimin e Nënkyetarit të Gjykatës Themelore në Prizren	5 min.
5	Kërkesë për fillimin e Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë për 37 (tridhjetë e shtatë) gjyqtarët me mandat fillestar të dekretuar me 21 janar 2019, si dhe propozimi i mentorëve për të njëjtit	10 min.
6	Emërimi i anëtarit të Panelit për Lirim me Kusht- deleguar nga Gjykata Themelore në Prishtinë	5 min.
7	Kërkesë për publikimin e tri pozitave për gjyqtarë të DHPGJS-së	10 min.
8	Shqyrtimi i Kërkesës së Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) për miratimin e procedurave për trajtimin e Padive të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë	10 min.
9	Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencionit “UBO Consulting” për realizimin e hulumtimit “Matja e perceptimit për popullatën kyçe të HIV dhe personave që jetojnë me HIV”	10 min.

10	Shqyrtimi i kërkesës së Rektorit të Kolegjit UBT z. Edmond Hajrizi, për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), si dhe autorizimi i Kryesuesit të KGJK-së për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit	10 min.
11	Të ndryshme	10 min.

Në rast të pamundësisë që të merrni pjesë luteni që të lajmëroheni në këtë nr. tel. 038-200 17 435.

Prishtinë, 20 shkurt 2019

Nehat IDRIZI,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës